



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

## V E N D I M

Nr. 145, datë 30.10.2020

**PËR  
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 122, DATË 28.09.2020, TË KËSHILLIT BASHKIAK  
“PËR SHPËRBLIMIN E KLUBIT TË FUTBOLLIT TIRANA, SI REZULTAT I FITIMIT  
TË KAMPIONATIT KOMBËTAR TË FUTBOLLIT 2019-2020**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, vendimit nr. 14, datë 12.10.2011, “Për transformimin në shoqëri aksionare të Klubit të Futbollit Tirana, miratimin e aktit të themelimit dhe statutit të shoqërisë aksionare “Klubi i Futbollit Tirana”, të ndryshuar, vendimit nr. 157, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”, të ndryshuar, nenit 112 dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

### V E N D O S I:

Në vendimin nr.122, datë 28.09.2020 të Këshillit Bashkiak “Për shpërblimin e Klubit të Futbollit Tirana, si rezultat i fitimit të kampionatit kombëtar të futbollit 2019-2020”, bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

1. Pikat 4 dhe 5 bashkohen në një pikë të vetme dhe riformulohen si më poshtë:  
“4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.”

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R**

**TONI GOGU**